

UDHËZIM
Nr. 1, datë 21.7.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 14.5.2009, “PËR
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR MIRATIMIN E
MATERIALEVE TË PËRKTHYERA TË LEGJISLACIONIT TË BE-SË NË GJUHËN
SHQIPE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, pikave 5 dhe 9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.3.2007 “Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së”, ministri i Integrimit Evropian

UDHËZON:

Në pikat 8 dhe 8.1 të udhëzimit nr. 2, datë 14.5.2009, “Për funksionimin e komisionit të posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe”, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 8 “Anëtarët e komisionit, të cilët janë ekspertë të jashtëm, do të shpërblehen për punën e kryer në vlerën 200 lekë për çdo faqe të shqyrtuar prej tyre”.
2. Pika 8.1 shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Ligjeve të BE-së dhe Sektori i Buxhetit dhe Financës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjasha